



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 762 Akti**

**Nr. 799 Vendimi**  
**Tiranë, më 17.9.2024**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 16.9.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), mori në shqyrtim mbi bazën e dokumenteve të administruara çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Nertila Ndrejoni**, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni G** i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;

**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017**, i Gjykatës Kushtetuese.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore dhe, pasi shqyrtoi çështjen që i përket subjektit të

rivlerësimi, znj. Nertila Ndregjoni, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Nertila Ndregjoni, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, ka mbajtur funksionin e ndihmëses/këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 4 të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzon statusin e subjektit të rivlerësimi dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimi kalimtar *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimi Nertila Ndregjoni, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimi, duke u shortuar në datën 15.6.2021 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Lulzim Hamitaj dhe Etleda Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimi të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK, në vijim AKSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me vendimin datë 21.6.2021, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimi të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimi dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 26.7.2021, subjekti i rivlerësimi u njoftua nëpërmjet postës elektronike<sup>1</sup> mbi fillimin e procesit të rivlerësimi kalimtar, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimi nëpërmjet postës elektronike<sup>2</sup> deklaroi marrjen dijeni dhe mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

6. Trupi gjykues me vendimin datë 9.9.2024 vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimi Nertila Ndregjoni, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimi mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 mbi të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimi për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin

<sup>1</sup> Email datë 26.7.2021, ora 14:44 “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimi dhe kërkesë për informacion shtesë”.

<sup>2</sup> Email-et datë 30.6.2021, ora 21:33 dhe datë 10.9.2021, ora 13:26 “Re: Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimi dhe kërkesë për informacion shtesë”.

e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe, më 9.9.2024, përmes postës elektronike<sup>3</sup> i njoftoi subjektit të rivlerësimit vendimin mbi përfundimin e hetimit paraprak. Subjekti i rivlerësimit u ftua të paraqesë prova dhe shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit brenda datës 13.9.2024.

**7.** Në datën 13.9.2024, subjekti i rivlerësimit paraqiti me anë të postës elektronike<sup>4</sup> shpjegime dhe prova në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht dhe, njëkohësisht, paraqiti këto shpjegime dhe prova në zyrën e protokollit pranë Komisionit, administruar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2024.

**8.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike<sup>5</sup> se trupi gjykues me vendimin e datës 14.9.2024 vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 16.9.2024, ora 12:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

**9.** Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Nertila Ndrejoni, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, vlerësimi i aftësive profesionale.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**10.** Në datën 16.9.2024 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

**11.** Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e hetimit administrativ nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

**12.** Subjekti i rivlerësimit, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

**13.** Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Nertila Ndrejoni, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit.

**14.** Seanca dëgjimore e datës 16.9.2024 u ndërpre, për të rifilluar në datën 17.9.2024, në orën 09:45, për shpalljen e vendimit.

**15.** Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 17.9.2024, subjekti i rivlerësimit Nertila Ndrejoni kërkoi konfirmimin në detyrë.

---

<sup>3</sup> Email datë 9.9.2024, ora 15:44 "Komisioni – Njoftim i përfundimit të rezultateve të hetimit kryesisht mbi procesin tuaj të rivlerësimit".

<sup>4</sup> Email datë 13.9.2024, ora 15:50.

<sup>5</sup> Email datë 14.9.2024, ora 15:18 "Ftesë për t'u dëgjuar lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit".

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**16.** Subjekti i rivlerësimit Nertila Ndregjoni ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**17.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**18.** Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

**19.** Referuar vendimit nr. 2/20176 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**20.** ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Nertila Ndregjoni, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI, në vitin 2010, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

---

<sup>6</sup> Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

**21.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

## **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**22.** Në kohën e plotësimit të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka qenë në përbërje familjare vetëm.

**23.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI dhe në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2010 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**24.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## **Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit**

### **1. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk ka pasuri.**

**1.1** Referuar informacionit të administruar nga ILDKPKI-ja, rezulton se ish-ZQRPP<sup>7</sup> ka konfirmuar se në emër të subjektit nuk figuron ndonjë pasuri e paluajtshme e regjistruar.

**1.2** FSHU-ja<sup>8</sup> informon se me gjeneralitetet Nertila B. Ndrejoni nuk figuron ndonjë abonent me kontratë furnizimi me energji elektrike.

<sup>7</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2018.

<sup>8</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2021.

**1.3** UKT-ja<sup>9</sup> informon se në emër të subjektit nuk rezulton asnjë e dhënë për kontratë shërbimesh Ujësjiellës-Kanalizime.

**1.4** DPSHTRR-ja<sup>10</sup> informon se në emër të subjektit dhe prindërve të saj, B. dhe N. N., nuk figurojnë mjete të regjistruara në pronësi të tyre.

## **Detyrimet**

### **2. Kontratë kredie në shumën 500.000 lekë**

**2.1** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar “Kontratë kredie konsumatore bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare në shumën principal 500.000 lekë, lidhur në datën 23.10.2015, me interes fiks 9% deri në datën 5.10.2016. Më pas, norma e interesit është e ndryshme sipas formulës së parashikuar në nenin 5 të kontratës”. Shuma e detyrimit të mbetur: 320.163,28 lekë. Për vërtetimin e deklaratimit subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues<sup>11</sup>.

**2.2** Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar “Kredi pranë BKT me kontratë datë 23.10.2015, në shumën 500.000 lekë”. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar shumën vjetore të shlyer për këtë kredi<sup>12</sup>.

**2.3** BKT-ja<sup>13</sup> konfirmon se ndërmjet subjektit dhe BKT-së është lidhur kontrata e kredisë bankare, e datës 23.10.2015, me objekt “Dhënie kredie në shumën 500.000 lekë”, me qëllim për blerje makine. Nga analizimi i lëvizjes së llogarive bankare, konstatohet se kjo kredi është lëvruar në datën 29.10.2015 dhe në datën 30.10.2015 subjekti ka tërhequr shumën 485.000 lekë.

**2.4** Në kushtet që nga hetimi nuk ka rezultuar automjet në emër të subjektit dhe subjekti nuk ka deklaruar automjet në pronësi të tij, me anë të pyetësorit nr. 1 Komisioni i kërkoi shpjegime lidhur me qëllimin e kredisë. Në përgjigje<sup>14</sup>, subjekti shpjegoi se qëllimi i marrjes së kredisë ka qenë për të përballuar disa shpenzime të shëndetit të nënës N. N., e cila vuan nga një sëmundje kronike, dhe se qëllimi i kredisë është shënuar për blerje automjeti sipas sugjerimit të oficerit të kredisë. Subjekti sqaroi se në kushtet në të cilat ndodhej (nevoja për kredinë që të kryente shpenzimet e nevojshme për nënën), pranoi që objekti i kredisë të ishte sipas sugjerimit të punonjësit të bankës, pasi për të kishte më shumë rëndësi financimi sesa përshkrimi i objektit të kredisë. Subjekti paraqiti një vërtetim nga Spitali \*\*\* për të vërtetuar situatën shëndetësore të nënës së saj<sup>15</sup>.

<sup>9</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2021.

<sup>10</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2021.

<sup>11</sup> Kontratë kredie bankare konsumatore e lidhur mes BKT dhe shtetases Nertila Ndrejoni, datë 23.10.2015; Kopje ID për shtetasen Nertila Ndrejoni; Kopje ID për shtetasen M. N.; Vërtetim kredie nr. ekstra prot., datë 20.1.2017, i lëshuar nga BKT-ja; Aneksi i planit të kredisë.

<sup>12</sup> Shlyer janar – dhjetor 2016, shuma 190.675 lekë, detyrimi i mbetur 320.163 lekë.

<sup>13</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2021.

<sup>14</sup> Përgjigje protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2024.

<sup>15</sup> Vërtetim datë 31.5.2024.

**2.5** Sa më lart, për sa kohë që nga hetimi referuar informacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja<sup>16</sup> nuk figuronte i regjistruar në emër të subjektit ndonjë automjet, nuk rezultojnë problematika lidhur me këtë kredi.

**2.6** Në vijim, Komisioni pasqyroi në analizën financiare shumën 485.000 lekë, tërhequr në datën 29.10.2015, si shpenzim gjatë vitit 2015. Gjithashtu, Komisioni pasqyroi si shpenzim shumat e shpenzuara për shlyerjen e kësaj kredie gjatë vitit 2015 dhe gjatë vitit 2016, të cilat kanë si burim të ardhurat e subjektit nga paga.

**2.7** Më tej, Komisioni konstaton se në këtë kontratë kredi figuron në cilësinë e dorëzanësit motra e subjektit, znj. M. N..

**2.8** Lidhur me statusin e motrës së subjektit në procesin e rivlerësimit, Komisioni vëren se marrëdhënia juridike e dorëzanisë, ndonëse përfaqëson interesa pasurorë, nuk hyn në rrethin e marrëdhënieve të cilësuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të cilat vendosin detyrimin e subjektit të rivlerësimit për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive<sup>17</sup>. Përveç këtij konkluzioni, Komisioni mban në konsideratë edhe faktin se shtetasja M. N., në cilësinë e dorëzanësit, e ka ushtruar këtë rol në kuptimin formal të tij, në kushtet kur nuk ka qenë e nevojshme që ajo të luajë rol efektiv në shlyerjen e kredisë me burimet e saj financiare, pasi të gjitha pagesat për shlyerjen e kësteve të kredisë, deri në momentin e mbylljes në vitin 2018, kanë pasur burim pagën e subjektit.

**2.9** Sa rezultoi, motra e subjektit, znj. M. N., nuk konsiderohet “person tjetër i lidhur”, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrimin për justifikimin e burimeve të krijimit të motrës së saj sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

**2.10 Në përfundim**, nuk konstatohen problematika lidhur me kredinë e marrë nga BKT-ja në vitin 2015.

### **Kredi të tjera ndër vite pranë BKT-së**

**2.11** Nga informacioni i përcjellë nga BKT-ja<sup>18</sup>, rezulton se ndërmjet subjektit dhe BKT-së janë lidhur edhe dy kontrata kredie bankare, konkretisht:

**2.11.1** Kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 20.7.2012, shuma 250.000 lekë, me afat 24 muaj, me qëllim financimin e nevojave personale. Nga analizimi i lëvizjes së llogarive bankare, konstatohet se kjo kredi është lëvruar në datën 20.7.2012 dhe në datën 9.8.2012 subjekti ka tërhequr shumën 300.000 lekë, e përbërë nga fondet e lëvruara nga kredia dhe kreditimi i pagës për muajin korrik 2012. Subjekti ka vijuar me pagesat mujore të kredisë dhe në datën 15.11.2013 ka paraqitur kërkesë për mbylljen e kredisë.

**2.11.2** Lidhur me aspektin deklarativ rezultoi se: (i) subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 shumën e kredisë së marrë nga BKT-ja në datën 20.7.2012; (ii) nuk ka deklaruar

<sup>16</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2021, DPSHTRR-ja informoi se nuk figurojnë mjete të regjistruara në emër të subjektit dhe prindërve të saj (B. dhe N. N.).

<sup>17</sup> Bazuar në jurisprudencën e KPA-së, në vendimet nr. 22/2022 (JR), datë 22.6.2022 (paragrafi 13.11); nr. 27, datë 6.7.2022 (paragrafi 37.2.1).

<sup>18</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2021.

në DIPP-në e vitit 2013 mbylljen e kredisë së marrë nga BKT-ja, sipas parashikimeve të shkronjës “dh” të nenit 4 dhe nenit 7 të ligjit nr. 9049/2003.

**2.11.3** Bazuar në qëndrimin e konsoliduar të mbajtur nga Kolegji<sup>19</sup>, pasaktësitë në deklaratimet periodike, për sa kohë nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

**2.11.4** Kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 22.11.2013, shuma 250.000 lekë, me afat 24 muaj, me qëllim financimin e nevojave personale. Nga analizimi i lëvizjes së llogarive bankare, konstatohet se kjo kredi është lëvruar në datën 22.11.2012 dhe në datën 22.11.2013 subjekti ka tërhequr shumën 246.000 lekë.

**2.11.5** Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar “Kredi e marrë pranë BKT-së në shumën 250.000 lekë, marrë në datën 22.11.2013”. Më tej, në DIPP-në e vitit 2015, ka deklaruar mbylljen e kësaj kredie në tetor të vitit 2015.

**2.11.5.1** Subjekti ka vijuar me pagesat mujore të kredisë, deri në mbylljen e saj, në datën 20.11.2015.

**2.12 Në konkluzion**, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe nuk u konstatuan problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit për sa i përket kredive të marra pranë BKT-së, në vitet 2012 dhe 2013.

### **3. Overdraft në vlerën 100.000 lekë**

**3.1** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar “*Overdraft* nga llogaria rrjedhëse bankare e pagës në limitin 100.000 lekë”. Shuma e detyrimit të mbetur: 89.460,56 lekë. Për vërtetimin e deklaratimit subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues<sup>20</sup>.

**3.2** Nga hetimi i Komisionit konstatohet se nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga BKT-ja<sup>21</sup>, rezulton se në datën 30.12.2016 gjendja e llogarisë ka qenë -89.460,56 lekë, në përputhje me deklaratimin e subjektit të rivlerësimit.

**3.3 Në konkluzion**, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe nuk u konstatuan problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit për sa i përket *overdraft*-it të deklaruar nga subjekti.

## **KONSTATIME TË TJERA**

### **4. Adresa banimi**

**4.1** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit (në seksionin të dhëna konfidenciale) ka deklaruar: “*Banoj në shtëpinë e prindërve, apartament banimi 36,34 m<sup>2</sup> me nr. hipoteke \*\*\*, datë 25 tetor 1996... rruga “\*\*\*”, pallati \*\*\*, Lagjja nr. \*\*\*, Njësia Administrative*

<sup>19</sup> Vendimet e Kolegjit: nr. 24/2021 (JR), datë 28.7.2021; nr. 28/2020 (JR), datë 23.10.2020; nr. 25/2021 (JR), datë 29.7.2021.

<sup>20</sup> Nxjerrje llogarie BKT, datë 20.1.2017.

<sup>21</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2021.



nr. \*\*\*, Tiranë”. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues<sup>22</sup>.

**4.2** Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Lagjja Nr. \*\*\*, Njësia Nr. \*\*\*, Tiranë. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të vitit 2010, subjekti ka deklaruar si adresë regjistrimi në gjendjen civile rrugën “\*\*\*\*”, Libri \*\*\*, faqe \*\*\*, Njësia Nr. \*\*\*, Tiranë dhe adresë tjetër qëndrimi rrugën “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, sh.\*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Të njëjtën deklaratë subjekti e ka bërë dhe në DIPP-në e vitit 2010. Në DIPP-në e vitit 2011 dhe DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar si adresë regjistrimi në gjendjen civile lagjja “\*\*\*\*”, Tiranë dhe nuk deklaron adresë tjetër qëndrimi. Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti nuk deklaron adresën e regjistrimit në gjendjen civile dhe adresë tjetër qëndrimi. Në vijim, në DIPP-në e vitit 2014 deklaron si adresë regjistrimi në gjendjen civile Njësia Nr. \*\*\*, Rruga \*\*\* dhe adresë tjetër qëndrimi rruga “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, Lagjja Nr. \*\*\*. Në DIPP-në e vitit 2015 nuk deklaron adresë regjistrimi banimi dhe qëndrimi. Në DIPP-në e vitit 2016 deklaron si adresë regjistrimi në gjendjen civile rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Lagjja Nr. \*\*\*, Njësia Nr. \*\*\*, Tiranë dhe nuk deklaron adresë tjetër qëndrimi. Në përgjigje të pyetësorit standard<sup>23</sup>, subjekti ka deklaruar: *“Nga fillimi i detyrës si këshilltare ligjore e deri më sot kam banuar në të njëjtën adresë, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Lagjja \*\*\*, Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë. Pronar i shtëpisë së banimit është babai im”*. Gjithashtu deklaron se nuk ka paguar qira.

**4.3** DPGJC-ja<sup>24</sup> informon se shtetasit Nertila, B. dhe N. N. janë transferuar familjarisht nga ZGJC-ja Komuna \*\*\*, Dibër, në datën 7.12.1990 dhe janë regjistruar në regjistrin themeltar rruga “\*\*\*\*”, fl \*\*\*, Njësia \*\*\*, Tiranë. Në vijim informon se në datën 26.7.2017 shtetasit e mësipërm janë transferuar nga Njësia Nr. \*\*\* në Njësinë Nr. \*\*\*, Bashkia Tiranë, në adresën rruga “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*.

**4.4** Njësia Administrative Nr. \*\*\*<sup>25</sup> e Bashkisë Tiranë informon se nga verifikimi i kryer në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010 familja Ndregjoni ka ardhur në Njësinë Administrative Nr. \*\*\*, në datën 25.7.2017, sipas dokumentit të pronësisë në rr. “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*. Nuk ka përcjellë dokumentin e pronësisë, duke sqaruar se sipas VKM-së 1243/2009<sup>26</sup> dokumentet ruhen për një afat 5-vjeçar.

**4.5** Për sa i përket ndryshimeve që kanë ndodhur në gjendjen civile, në përgjigje të pyetësorit standard<sup>27</sup> subjekti ka deklaruar: *“Në vitin 2011 e në vijim sqarohet se rezultatet kryefamiljare e ndarë nga trangu familjar, por kam jetuar në të njëjtën shtëpi me prindërit”*. Komisioni vëren se referuar shkresës datë 30.5.2024, lëshuar nga Njësia Bashkiake Tiranë

---

<sup>22</sup> Kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. \*\*\*, datë 25.10.1996.

<sup>23</sup> Email datë 10.9.2021.

<sup>24</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2024.

<sup>25</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2024.

<sup>26</sup> Për përcaktimin e dokumenteve që duhet të paraqesin shtetasit dhe të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile, në bashki/njësi bashkiake/komuna, dhe institucionet shtetërore të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve.

<sup>27</sup> Email datë 10.9.2021.

Nr. \*\*\* (të paraqitur në cilësinë e provës në përgjigje të pyetësorit nr. 1), rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer veçim nga trangu familjar me procesverbal nr. \*\*\*, datë 19.4.2012.

**4.6** Pas analizimit të adresave të deklaruara nga subjekti, me anë të pyetësorit nr. 1 Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë marrëdhënien me pronat me adresë: (i) rr. “\*\*\*\*”, libri \*\*\*, faqe \*\*\*, Njësia Nr. \*\*\*, Tiranë; (ii) Njësia Nr. \*\*\*, Rruga \*\*\*; (iii) rruga “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*.

**4.7** Në përgjigje<sup>28</sup>, subjekti sqaroi se: (i) Në deklaratën para fillimit të detyrës, në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në gjendjen civile”, ka deklaruar rr. “\*\*\*\*”, libri \*\*\*, faqe \*\*\*, Njësia Nr. \*\*\*, Tiranë. Ndërsa në rubrikën “Nëse dispononi vend qëndrimi tjetër, adresa e plotë ku banoni”, ka deklaruar rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, sh. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Adresa e banimit nga momenti i deklarimit për herë të parë dhe aktualisht është rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, sh. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, e ndryshuar në rrugën “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*. Në lidhje me adresën ku është regjistruar gjendja civile, ka deklaruar adresën në gjendjen civile të Njesisë Bashkiake Nr. \*\*\*; (ii) Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar adresën e banimit dhe nuk ka deklaruar adresën e regjistruar të gjendjes civile. Gabimisht në deklaratën *Vetting* ka deklaruar Njësia Administrative Nr. \*\*\*, në vend të deklarimit të saktë të Njesisë Administrative Nr. \*\*\*. Deri në datën 26.7.2017 gjendja civile e regjistruar e familjes ka qenë në Njësinë Bashkiake Nr. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”. (iii) Subjekti deklaroi se në datën 26.7.2017 familja ka ndryshuar gjendjen civile duke u regjistruar në gjendjen civile që i përket apartamentit të banimit në pronësi të prindërve. Me vërtetimin e datës 30.5.2024, lëshuar nga Njësia Administrative Nr. \*\*\*, është përcjellë informacioni se babai i subjektit është regjistruar në këtë gjendje civile në datën 7.12.1990, ardhur nga gjendja civile \*\*\*, Dibër. Nga momenti i ardhjes së babait në Tiranë dhe deri në momentin e privatizimit të banesës, familja ka jetuar në një banesë në Njësinë Administrative Nr. \*\*\*. Kjo banesë rezultoi t’i jetë dhënë babait të subjektit në atë kohë nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor, pasi rezultoi se ishim të pastrehë dhe nuk kishim strehim në Tiranë. Për shkak të lehtësive në marrjen e certifikatave dhe vërtetimeve që mund të nevojiteshin në atë periudhë, adresa ka mbetur si adresa e mëparshme, pra Njësia Administrative Nr. \*\*\*. Me ndryshimet e pësuar në ligjin “Për sistemin e adresave”, familja ka saktësuar adresën e banimit sipas apartamentit në pronësi. Në momentin e transferimit të adresës, kanë qenë nëpunësit e gjendjes civile nr. \*\*\* që i kanë dhënë punonjëses së gjendjes civile adresën e saktë të banimit, duke përcaktuar rrugën, pallatin, hyrjen dhe numrin e apartamentit. Adresa e saktë e banimit është: rruga “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*.

**4.8** Komisioni vëren se në cilësinë e provës subjekti ka paraqitur shkresën e lëshuar nga Njësia Bashkiake Tiranë Nr. \*\*\*, datë 30.5.2024, sipas së cilës bëhet me dije se sipas regjistrimit themeltar të shtetasve në rr. “\*\*\*\*”, \*\*\*, fleta \*\*\*, figurojnë të regjistruar prindërit e subjektit të ardhur nga gjendja civile \*\*\*, Dibër, në datën 7.12.1990. Më tej, është paraqitur vendimi nr. \*\*\*, datë 27.11.1991, lëshuar nga Komiteti Ekzekutiv i Kuvendit Popullor, Lagjja \*\*\*, Tiranë, dhe autorizim për strehë të këshillit popullor të lagjes, sipas të cilit “z. B. N. do të strehohet në rrugën “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, ku do të marrë në dispozicion një dhomë e një kuzhinë (me përbërje familjare burrë, grua, nënë dhe 4

<sup>28</sup> Përgjigje protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2024.

fëmijë)”. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 25.10.1996, të lidhur ndërmjet EKB-së dhe shtetasve B., N. e S. N., për apartamentin e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, blloku “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë.

**4.9** Komisioni konstaton se rruga “\*\*\*\*” kryqëzohet në një pikë me rrugën “\*\*\*\*”, çka nënkupton se ndodhen në të njëjtin bllok/vendndodhje dhe e bën bindës shpjegimin e subjektit se pas saktësimit të adresave apartamenti i deklaruar në rrugën “\*\*\*\*”, blloku “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, ka marrë adresën e re: rr. “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë.

**4.10 Lidhur me banesën në pronësi të prindërve, me adresë rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\* Lagjja Nr. \*\*\*, Njësia Nr. \*\*\*, Tiranë** - Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 dhe në përgjigje të pyetësorit standard<sup>29</sup>, të administruar dhe ASHK Tirana Jug<sup>30</sup>, rezulton se ndërmjet palës shitëse Dega e Entit Kombëtar të Banesave në Tiranë dhe palë blerëse shtetasit B. N. (babai i subjektit), N. N. (mamaja e subjektit) dhe S. N. (gjyshja e subjektit), është lidhur kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 25.10.1996, sipas së cilës EKB-ja u ka kaluar shtetasve të mësipërm pronësinë e një apartamenti në katin e tretë, të përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë dhe ambient tjetër ndihmës me sip. 68,34 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “\*\*\*\*”, blloku “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Në kontratë përcaktohet se meqenëse blerësi ka statusin e të përndjekurit politik<sup>31</sup>, këtë apartament e përfiton falas.

**4.11** Referuar dispozitave ligjore të kohës, rezulton se ligji nr. 7748/1994 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, në nenin 12<sup>32</sup> parashikonte detyrimin e qeverisë që me anë të akteve të veçanta të saj t’u garantojë të përndjekurve politikë (sipas kategorisë) krijimin e lehtësirave dhe të përparësive të kërkesave të tyre individuale apo kolektive në disa fusha, mes të cilave ishte dhe fusha e ndërtimit dhe strehimit. Në vijim, VKM-ja nr. 476/1994<sup>33</sup> “Për procedurat e strehimit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” ka parashikuar që ish të përndjekurit politikë që kanë fituar sipas ligjit statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist, përfitojnë banesë falas.

**4.12** FSHU-ja<sup>34</sup> informon se me gjeneralitetet B. Y. N. identifikohet 1 abonent me kontratë furnizimi Nr. \*\*\*, në instancën Tiranë, me adresë rruga “\*\*\*\*”.

**4.13** UKT-ja<sup>35</sup> informon se në emër të shtetasit B. N. rezulton kontrata nr. \*\*\* për objektin me adresë në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, me status “aktiv” në kategorinë e konsumatorëve familjarë. Bashkëlidhur, UKT-ja ka vënë dispozicion kopje të vërtetimit nga dokumenti hipotekor të

<sup>29</sup> Kontratë shitjeje apartamenti banimi me pagesë të menjëhershme, datë 24.10.1996.

<sup>30</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2024.

<sup>31</sup> Në bazë të vendimit nr. \*\*\* të rajonit nr. \*\*\* dhe në bazë të ligjit nr. 7748, datë 1.6.1994, i ndryshuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.10.1994.

<sup>32</sup> Neni 12: “Të gjithë atyre personave që përfshihen në nenin 3, pikat a, b, c dhe d, qeveria me anë të akteve të veçanta të saj do t’u garantojë krijimin e lehtësirave dhe të përparësive të kërkesave të tyre individuale apo kolektive në fushat e mëposhtme: të veprimtarisë ekonomike, financiare dhe sociale: c) Në fushën e ndërtimeve dhe strehimit...”

<sup>33</sup> “3. Për efekt të zbatimit të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, ndryshuar me ligjin nr. 7828, datë 1.6.1994, do të përfitojnë banesë falas kategoritë e mëposhtme të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, që kanë fituar sipas ligjit statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist...”

<sup>34</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2021.

<sup>35</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2021.

apartamentit me sip. 69,1 m<sup>2</sup> në pronësi të shtetasve F. e L. B., me shënimin “MEMO = emri është F. B. u bë B. N.”.

**4.14** Sa rezultoi, Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1<sup>36</sup> kërkoi shpjegime nga subjekti, i cili në përgjigje<sup>37</sup> sqaroi se Ujësjellës-Kanalizime Tiranë ka ndryshuar gabimisht emrin nga z. B. N. në z. F. B.. Për të ndrequr këtë gabim, ndërmarrja UKT ka bërë saktësim të kontratës. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2013, drejtuar babait të subjektit, i është kthyer përgjigje kërkesës së bërë nga ana e tij, në datën 10.12.2012, duke e vënë në dijeni se në muajin mars 2011 është bërë gabimisht ndryshimi i emrit nga z. B. N. në z. F. B.; gabim i cili është korrigjuar pas kërkesës së paraqitur në datën 10.12.2012. Ndërmarrja UKT sh. a. ka konfirmuar se në bazë të dokumentacionit të dorëzuar kjo kontratë i përket apartamentit në pronësi të prindërve të subjektit. Si përfundim, kontrata e lidhur nga UKT sh. a. është ndryshuar gabimisht në emër të z. F. B., duke u korrigjuar sërish.

**4.15** Nga hetimi rezultoi se referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2013, të lëshuar nga UKT-ja, babai i subjektit në vitin 2012 ka depozituar një kërkesë “Për saktësim kontrate”. UKT-ja informon se ky institucion ka bërë gabimisht ndryshimin e emrit në muajin mars të vitit 2011 nga z. B. N. në z. F. B..

**4.16 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se për sa kohë nga hetimi nuk rezultoi që subjekti dhe prindërit e tij të kenë në pronësi apartament tjetër, përveç atij të deklaruar me adresë në rr. “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, nuk konstatohen problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016 lidhur me adresat e deklaruara të banimit.

## **5. Llogaria bankare e babait të subjektit pranë Raiffeisen Bank**

**5.1** Nga analizimi i llogarive bankare, u konstatua se në llogarinë bankare të babait të subjektit janë kryer disa transferta nga palë të treta me përshkrimin “Sponsorizime”, dhe gjithashtu janë kryer disa depozitime nga ana e babait të subjektit<sup>38</sup>. Shumat e transferuara/depozituara janë tërhequr herë pas here nga babai i subjektit.

**5.2** Me anë të pyetësorit nr. 1 subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këto transaksione. Në përgjigje, subjekti Nertila Ndrejoni fillimisht parashtroi se babai i saj, në kuptim të procesit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohet si person i lidhur, pasi ai nuk ka qenë pjesë e trungut të saj familjar dhe se subjekti është shkëputur nga trungu familjar i origjinës që nga viti 2012. Pavarësisht kësaj, subjekti sqaroi se babai prej 34 vitesh është aktivist i të drejtave dhe lirive të njeriut, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të mbijetuarve të diktaturës dhe ish të burgosurve e të përndjekurve politikë dhe se nga viti 2014 është president i Unionit Mbarëkombëtar të Integritit të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, një organizatë jofitimprurëse, por dokumentuese ndaj krimit komunist në Shqipëri. Referuar ligjit nr. 7748, datë 4.8.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të

---

<sup>36</sup> Email datë 29.5.2004.

<sup>37</sup> Protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2024.

<sup>38</sup> Datë 28.7.2011, shuma 50.000 lekë; datë 12.9.2011, shuma 80.000 lekë; datë 5.5.2014, shuma 200.000 lekë; datë 2.6.2014, shuma 210.000 lekë; datë 21.1.2015, shuma 50.00 lekë; datë 2.3.2015, shuma 50.00 lekë; datë 9.3.2015, shuma 50.00 lekë; datë 19.3.2015, shuma 50.00 lekë; datë 1.6.2015, shuma 200.00 lekë; datë 2.9.2015, shuma 90.00 lekë; datë 9.10.2015, shuma 300.00 lekë; datë 9.10.2015, shuma 300.000 lekë; datë 27.11.2015, shuma 302.770 lekë; datë 17.3.2016, shuma 60.000 lekë; datë 19.4.2016, shuma 205.000 lekë; datë 25.5.2016, shuma 26.000 lekë; datë 27.7.2016, shuma 100.000 lekë; datë 26.10.2016, shuma 200.000 lekë, datë 23.11.2016, shuma 110.000 lekë.

përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të përndjekurit politikë janë organizuar në mënyrë të thjeshtë dhe kanë kryer veprimtari publike për të treguar krimet dhe dënimet e paligjshme që ka kryer ish-regjimi komunist në Shqipëri, nga viti 1944 deri në vitin 1990, duke organizuar evente të ndryshme, takime, aktivitete të ndryshme përkujtimore etj., para vitit 2014, të cilat provohen me aktet shkresore provuese bashkëlidhur këtyre shpjegimeve, deklaroi subjekti. Babai i saj, si një nga organizatorët kryesorë të këtyre aktiviteteve të kryera me iniciativën e tij personale si aktivist i të drejtave dhe lirive të ish të burgosurve, dhe si ish të përndjekur politikë, ka mbledhur fondet e dhëna nga të ardhurat personale të tyre, me qëllim realizimin e këtyre aktiviteteve, të faktuara më së paku që nga viti 2011. Më pas, në kushtet kur aktivitetet e kryera nga ish të përndjekurit, si dhe rëndësia për t’i bërë ato sa më publike dhe për t’i servirur në opinionin e gjerë publik, ka kërkuar që të siguronte sponsorizime në përputhje me ligjin.

**5.3** Konkretisht, subjekti deklaroi se depozitimet e kryera në llogarinë bankare nga babai i saj i përkasin kontributit të dhënë nga të gjithë ata ish të përndjekur, subjekte juridike dhe individë, që kishin vullnetin për të kryer aktivitete sociale dhe mediatike, për të dëshmuar dhe për të bërë publikisht të ditura padrejtësitë që ka kryer pushteti komunist gjatë diktaturës 50-vjeçare në Shqipëri. Këto fonde të dhëna *cash* babait janë përdorur me qëllim realizimin e objektivave për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ish të burgosurve, evidentimin e viktimitave të gjenocidit komunist, organizimin e konferencave dhe aktiviteteve të ndryshme. Vlera monetare për aktivitete të ndryshme është depozituar në bankë për efekt të transparencës, që të vërtetohej se shumatat do të shpenzoheshin për kryerjen e aktiviteteve.

**5.4** Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti: (i) deklaratë noteriale të babait të saj, ku konfirmohen deklaratimet e subjektit; (ii) disa deklarata noteriale të lëshuara nga individë dhe shoqëri tregtare, të cilat konfirmojë se kanë kontribuar financiarisht sipas mundësive të tyre financiare, me qëllim realizimin e objektivave dhe aktiviteteve për integrimin e të burgosurve e të përndjekurve politikë të Shqipërisë<sup>39</sup>; (iii) foto nga aktivitetet e zhvilluara.

**5.5** Lidhur me transfertat bankare të kryera nga palë të treta në llogarinë e babait, subjekti shpjegoi se ato janë kryer nga ish të përndjekur dhe individë të ndryshëm, të cilët kanë sponsorizuar për aktivitete, organizime dhe evente të ndryshme të organizuara dhe drejtuara nga babai i saj, në pozicionin si drejtues i këtyre aktiviteteve dhe këto shuma të arkëtuara i ka përdorur me qëllim përballimin e shpenzimeve dhe realizimin e objektivave të përcaktuar për aktivitetet.

**5.6** Komisioni vëren se rezultoi e provuar se babai i subjektit është i angazhuar për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të mbijetuarve të diktaturës dhe ish të burgosurve dhe të përndjekurve politikë, çka konfirmohet edhe nga kërkimi në burime të hapura (internet).

---

<sup>39</sup> (i) Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 10.6.2024, e shtetasit H. F., ish i burgosur politik; (ii) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 10.6.2024, e shtetasit P. G., ish i përndjekur politik, (iii) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 8.6.2024, e shtetasit H. E.; (iv) kjo kompani ka kontribuar në vlerën 200.000 lekë dhe ky donacion i është paguar shtetasit B. N. në cilësinë e aktivistit të të drejtave dhe lirive të njeriut, për të realizuar foto-ekspozitën për shtetasin P. C.; (v) vërtetim datë 4.6.2024, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 2.6.2014 ka kontribuar me një donacion në vlerën 210.000 lekë dhe se ky donacion i është dhënë shtetasit B. N. për të mundësuar organizimin e aktivitetit “Konferenca për gjetjen e eshtrave të të zhdukurve në periudhën e komunizmit në Shqipëri”.

**5.7** Krahas llogarisë bankare të trajtuar në vendim, Raiffeisen Bank<sup>40</sup> bën me dije se shtetasi B. N. rezulton pronar dhe administrator i subjektit “\*\*\*” dhe administrator i shoqatës “\*\*\*”.

**5.8** Komisioni konstatoi se lëvizjet e llogarisë në emër të subjektit “\*\*\*” fillojnë nga data 17.8.2010, ndërsa lëvizjet e llogarisë në emër të shoqatës “\*\*\*” fillojnë nga data 18.11.2014.

**5.9** Në kushtet që veprimet e depozitimeve janë kryer në llogarinë personale bankare të babait të subjektit, ndërkohë që ekzistonin llogari bankare në emër të shoqatës përkatëse, Komisioni për efekt të analizës financiare e paraqiti balancën e llogarisë individuale të babait të subjektit si pjesë e analizës financiare vjetore për subjektin dhe prindërit.

**5.10** Në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se është shkëputur nga trangu familjar përpara periudhës së rivlerësimit, në datën 19.4.2012. Për këtë arsye, prindërit nuk mund të konsiderohen persona të lidhur dhe Komisioni nuk mund ta ngarkojë me barrë prove mbi gjendjen e llogarisë së babait në vitin 2015, kur analiza financiare dhe barra e provës në këtë vit lidhet vetëm me gjendjen e llogarisë bankare të babait në Raiffeisen Bank, e cila në datën 31.12.2015 paraqitet me gjendje në shumën 509.909,44 lekë. Subjekti gjithashtu deklaroi se prindërit e saj nuk kanë pasur detyrimin për të deklaruar pasuritë e tyre dhe se në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar vetëm të ardhurat e saj nga paga. Më tej, subjekti përmendi përsëri faktin se babai i saj ka vepruar në cilësinë e aktivistit të të drejtave dhe lirive të njeriut, vërtetuar kjo nga dekorata dhe tituj të ndryshëm, që ka vënë në dispozicion të Komisionit<sup>41</sup>, të tilla si titulli “Doktor i marrëdhënieve ndërqeveritare dhe humanitare”, i dhënë nga Universiteti Amerikan për Paqen Botërore, titulli “Mjeshtër i Madh” i dhënë sipas Dekretit nr. \*\*\*, datë 26.2.2012, nga Presidenti i Republikës, titulli “Ambasador për Paqen”, i dhënë nga Federata Universale e Paqes, titulli “Nderi i Qarkut Tiranë”, i akorduar nga Këshilli i Qarkut Tiranë, titulli “Qytetar Nderi”, i dhënë nga Bashkia Peshkopi, titulli “Kostandini i Madh”, i akorduar nga Akademia Monarkiste Shqiptare. Në përputhje me këtë mision, të bërë të ditur në mënyrë publike dhe në nivel ndërkombëtar, rezulton se babai, si një aktivist me kontribut të spikatur në këtë fushë, ka vepruar jo në emër të shoqatës. Për rrjedhojë, nuk ishte detyrim transferimi i donacioneve në llogari të shoqatës, duke qenë se këto aktivitete janë të ideuara dhe organizuara nga ai në bazë të kontributeve të derdhura nga donatorë. Në dritën e këtyre fakteve është lehtësisht e kuptueshme se gjendja monetare në llogarinë bankare të babait, në Raiffeisen Bank, në datën 31 dhjetor të çdo viti, nuk i përket atij. Pavarësisht se shumat përkatëse janë depozituar në këtë llogari bankare, ato nuk duhet të konsiderohen si të ardhura personale të babait, por si donacione të depozituara përkohësisht aty nga persona të ndryshëm, të cilat shpenzoheshin sipas nevojave përkatëse që lidheshin me aktivitetet e organizuara nga ai, i cili në këtë rast ka shërbyer si mbajtës apo administrator i kësaj llogarie, e cila vetëm *de jure* ishte hapur në emër të tij, pasi *de facto* përdorej në funksion të realizimit të aktiviteteve sensibilizuese, të cilat mbuloreshin nga shumat monetare të tërhequra prej tij për efekt të shpenzimeve përkatëse të kryera në përputhje me një funksion të tillë. Në asnjë rast shumat e depozituara në këtë llogari nuk lidhen me aktivitetin e shoqatës, e cila ka personalitet juridik të veçantë, duke pasur në këtë

<sup>40</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2021.

<sup>41</sup> Paraqitur në cilësinë e provës, në përgjigje të rezultateve të hetimit kryesisht.

mënyrë arkë dhe buxhet të miratuar sipas programit të aktiviteteve që mbulohen nga vetë ajo. Në përfundim, subjekti deklaroi se: “Konstatimi mbi mungesën e burimeve financiare të ligjshme në shumën 160.553 lekë, në vitin 2015, nuk mund të më atribuohet mua si subjekt rivlerësimi, jo vetëm për shkak se prindërit e mi nuk duhet të konsiderohen persona të lidhur, por edhe për shkak se kjo balancë negative vjen nga gjendja e llogarisë së babait në datën 31.12.2015, gjendje e cila nuk përfaqëson një shtesë në kursimet e prindërve, por një gjendje monetare tranzit, e cila do të pakësohet në momentin kur babai bashkë me aktivistët e tjerë kontribues do të duhet të përballojnë shpenzimet e aktiviteteve.”

## **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**5.11** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**5.12** Bazuar në praktikën e Kolegjit<sup>42</sup>, Komisioni vlerëson se në zbatim të ligjit nr. 84/2016, vetëm në kushtet kur prindërit e subjektit të rivlerësimit janë në të njëjtën certifikatë familjare me të përgjatë periudhës së rivlerësimit, ata konsiderohen persona të lidhur me të dhe, si të tillë, kanë detyrimin për deklarimin e pasurive që ata disponojnë në momentin e plotësimit të kësaj deklaratë dhe të burimeve të krijimit të tyre, sipas parashikimit të nenit 3, pika 13 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Sa rezulton, vlen të përmendet fakti se Komisioni nuk i ka kualifikuar prindërit e subjektit Nertila Ndrejoni si persona të lidhur me të, në kushtet kur subjekti ka bërë ndarje nga trangu familjar në datën 19.4.2012. Por, për arsye se kanë pasur jetesë të përbashkët faktike sipas deklaratimeve të vetë subjektit, Komisioni përfshiu në analizën financiare edhe prindërit. Gjithashtu, në kushtet që veprimet e depozitimeve të mësipërme janë kryer në llogarinë personale bankare të babait të subjektit dhe jo në llogarinë bankare të shoqatës përkatëse, Komisioni, për efekt të analizës financiare të pasqyruar në pikën 7 të këtij vendimi, e paraqiti balancën e llogarisë individuale të babait të subjektit si pjesë të analizës financiare vjetore për subjektin dhe prindërit.

## **6. Gjendje *cash* të deklaruara në vite**

**6.1** Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore rezulton se në DIPP-në e vitit 2011 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “Shtuar gjendje *cash* në banesë për vitin 2011 me kursime nga pagat. Shuma 500.000 lekë” dhe në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar “Shtuar gjendje *cash* në banesë për vitin 2012 me kursime nga pagat. Shuma 300.000 lekë” .

**6.2** Në vijim, në deklaratat e mëpasshme vjetore, subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në banesë, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* nuk ka deklaruar kursime në formën e likuiditeteve *cash*.

---

<sup>42</sup> Vendimi nr. 26 (JR), datë 3.7.2023.

**6.3** Me anë të pyetësorit nr. 1<sup>43</sup>, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti lidhur me konstatimet e mësipërme dhe në përgjigje<sup>44</sup> subjekti sqaroi se deklaratimet e kursimeve në këto deklaratat janë shprehur në konceptin e lekëve “të vjetër” në vitet 2011 dhe 2012. Të ardhurat nga paga në këto vite janë deklaruar sipas vërtetimeve të lëshuara nga qendra e punës, dhe se kur ka deklaruar të ardhurat *cash*, ka shprehur kursime në konceptin e lekëve “të vjetër”. “Këto kanë qenë vitet e para të plotësimit të deklaratave dhe herët e para të deklarimit të kursimeve në *cash* dhe, për shkak të mungesës së trajnimeve dhe eksperiencës në plotësimin e deklaratave, është krijuar konfuzion në deklarimin e kursimeve *cash*”, vijoi subjekti. Më tej deklaroi se: “Nëse kursimet e mia nga paga do të ishin 500.000 lekë dhe jo 50.000 lekë, sikurse duhet të ishte deklaruar në fund të vitit 2011, nuk do të kisha nevojë të merrja kredi konsumatore në BKT, në datën 20.7.2012, sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., pasi do të kisha të disponueshme kursimet *cash*, të cilat janë dy herë sa shuma e marrë kredi. Gjithashtu, në vitin 2012, nuk ka as logjikë ekonomike dhe as aritmetike që të marr kredi po shumë më 250.000 lekë dhe, nga ana tjetër, të kursej në këtë vit shumë prej 300.000 lekësh, si dhe të rezultoj me *overdraft* në fund të vitit 2012, në shumë më -49.892,36 lekë”. Në përfundim, subjekti shpjegoi se kursimet në fund të vitit 2012 kanë qenë në shumë më 80.000 lekë (50.000 lekë në vitin 2011 dhe 30.000 lekë të shtuara në vitin 2012) dhe se gjatë vitit 2013 kursimet e mbajtura *cash* janë depozituar në bankë. Konkretisht, në datën 15.11.2013, ka depozituar në bankë kursime në shumë më 140.010 lekë, që u përkasin kursimeve 80.000 lekë në fund të vitit 2012 dhe 60.000 lekë të ardhura të mbajtura *cash*, që kishin si burim pagat e vitit 2013 deri në momentin e depozitimit të shumës. Në fund të vitit 2013, kursimet *cash* kanë qenë 0 lekë dhe nuk ka pasur në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* kursime *cash*.

**6.4** Komisioni vëren se bazuar në nenin 32, pika 5<sup>45</sup> e ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit shqyrtojnë deklaratat periodike vjetore të subjektit, për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve lidhur me gjendjen reale financiare të tij dhe për të vërtetuar nëse ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për krijimin e pasurisë.

**6.5** Për këtë arsye, Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2011 dhe 2012, për të verifikuar burimet e ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara në këto vite, duke u qëndruar shumë më të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike. Në këtë analizë financiare u konsideruan: (i) ndryshimi i likuiditeteve *cash*; (ii) ndryshimi i likuiditeteve në bankë<sup>46</sup>; (iii) të ardhurat e subjektit nga pagat<sup>47</sup>; (iv) të ardhurat e nënës së subjektit nga

---

<sup>43</sup> Email datë 29.5.2004.

<sup>44</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2024.

<sup>45</sup> “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.”

<sup>46</sup> E përllogaritur si diferencë midis gjendjes së llogarive bankare (subjekti, nëna, babai) në fund të vitit me atë në fillim të vitit.

<sup>47</sup> Vërtetim page, lëshuar nga Gjykata e Lartë, nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2017.



pensioni<sup>48</sup>; (v) shpenzime jetese<sup>49</sup>; (vi) shpenzime për shlyerjet e kredive<sup>50</sup>; (vii) shpenzim i kredive të marra; (viii) shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS<sup>51</sup>.

**6.6** Pas përlogaritjes, analiza financiare për vitin 2011 rezultoi me një balancë negative mospërfillëse prej 9.981 lekësh, pra edhe në rastin që shumat e kursyera *cash* konsiderohen të jenë 500.000 lekë dhe 300.000 lekë (përkundrejt shumave 50.000 lekë dhe 30.000 lekë që pretendon subjekti), ndërkohë që balanca për vitin 2012 rezultoi në vlerën pozitive prej 192,706 lekësh. Sa rezulton, subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara në vitet 2011 dhe 2012.

**6.7 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në DIPP-në e vitit 2013, pasi nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash*, por bazuar në qëndrimin e konsoliduar të mbajtur nga Kolegji<sup>52</sup>, pasaktësitë në deklaramet periodike, për sa kohë nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

## 7. Analiza financiare

**7.1** Sikurse u përmend më sipër në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit Nertila Ndrejoni ka bërë ndarje nga trangu familjar në datën 19.4.2012<sup>53</sup>, por në kushtet që ka pasur jetesë të përbashkët faktike (sipas deklarameve të vetë subjektit), në analizën financiare u përfshinë edhe prindërit e subjektit.

**7.2** Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.11.2010 – 31.12.2016, e cila paraqitet e përmbledhur në vijim. Në këtë analizë financiare u konsideruan: (i) ndryshimi i likuiditeteve *cash*; (ii) ndryshimi i likuiditeteve në bankë<sup>54</sup>; (iii) të ardhurat e subjektit nga pagat<sup>55</sup>; (iv) të ardhurat e nënës së subjektit nga pensioni<sup>56</sup>; (v) ndryshimi i likuiditeteve; (vi) shpenzime jetese<sup>57</sup>; (vii) shpenzime për shlyerjet e kredive<sup>58</sup>; (viii) shpenzim i kredive të marra; (ix) shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS<sup>59</sup>.

<sup>48</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2024, e ISSH-së.

<sup>49</sup> Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së.

<sup>50</sup> Shumat e evidentuara në llogarinë e subjektit të rivlerësimit pranë BKT-së për pagesën e interesave, principalit dhe shpenzimeve të tjera lidhur me kredinë.

<sup>51</sup> Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në lëvizjet hyrje-dalje të sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur dhe u krahasuan/plotësuan me deklaramet e subjektit. Kostot u përcaktuan referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit [vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019].

<sup>52</sup> Vendimet e Kolegjit: nr. 24/2021 (JR), datë 28.7.2021; nr. 28/2020 (JR), datë 23.10.2020; nr. 25/2021 (JR), datë 29.7.2021.

<sup>53</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2024, lëshuar nga DPGJC-ja.

<sup>54</sup> E përlogaritur si diferencë midis gjendjes së llogarive bankare (subjekti, nëna, babai) në fund të vitit me atë në fillim të vitit.

<sup>55</sup> Vërtetim page, lëshuar nga Gjykata e Lartë, nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2017.

<sup>56</sup> Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2024, të ISSH-së.

<sup>57</sup> Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së.

<sup>58</sup> Shumat e evidentuara në llogarinë e subjektit të rivlerësimit pranë BKT-së për pagesën e interesave, principalit dhe shpenzimeve të tjera lidhur me kredinë.

<sup>59</sup> Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur dhe u krahasuan/plotësuan me deklaramet e subjektit. Kostot u përcaktuan referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit [vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019].

**Tabela nr.1 – Analiza financiare**

Përshkrim	1.11.2010- 31.12.2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shtim/pakësim likuiditete cash	0	500,000	300,000	0	0	0	0
Shtim/pakësim likuiditete bankë	20,006	-22,939	-62,439	-15,596	39,200	428,529	-291,128
<b>Total pasuri</b>	<b>20,006</b>	<b>477,061</b>	<b>237,561</b>	<b>-15,596</b>	<b>39,200</b>	<b>428,529</b>	<b>-291,128</b>
Kredi pranë BKT	0	0	250,000	250,000	0	500,000	0
<b>Total detyrime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>250,000</b>	<b>250,000</b>	<b>0</b>	<b>500,000</b>	<b>0</b>
Të ardhura subjekti nga pagat	141,482	759,259	804,316	805,286	990,611	977,941	971,738
Të ardhura nëna e subjektit nga pensioni	25,862	158,377	164,389	169,747	196,851	231,064	233,370
<b>Total të ardhura</b>	<b>167,344</b>	<b>917,636</b>	<b>968,705</b>	<b>975,033</b>	<b>1,187,462</b>	<b>1,209,005</b>	<b>1,205,108</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT (3 persona)	68,310	409,860	423,072	423,072	659,994	672,828	705,276
Shpenzime për shlyerje kredie (principal, interesa, etj)	0	0	65,312	245,556	147,741	176,999	190,709
Shpenzim kreditë e marra pranë BKT	0	0	250,000	246,400	0	485,000	0
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	0	40,696	50,054	131,844	107,777	106,202	0
<b>Total shpenzime</b>	<b>68,310</b>	<b>450,556</b>	<b>788,438</b>	<b>1,046,873</b>	<b>915,512</b>	<b>1,441,029</b>	<b>895,985</b>
<b>Balanca e fondeve (Të ardhura+detyrime-pasuri-shpenzime)</b>	<b>79,028</b>	<b>-9,981</b>	<b>192,706</b>	<b>193,756</b>	<b>232,750</b>	<b>-160,553</b>	<b>600,251</b>

**7.3** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit lidhur me konstatimin se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe prindërit kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 160.553 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e llogarive bankare gjatë vitit 2015”*.

**7.4** Në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se: *“Në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë kursimet gjendje të prindërve. Në datën 1.11.2010, kursimet e prindërve janë konsideruar 0 lekë, gjithashtu dhe në vitet në vazhdim. Pavarësisht se analiza financiare në vitet 2010, 2012, 2013 dhe 2014 paraqitet me balancë pozitive dhe me balancë fondesh pozitive, këto janë konsideruar si teprica, pasi nuk janë deklaruar si gjendje cash. Prindërit nuk kanë qenë asnjëherë subjekt deklarues dhe, për rrjedhojë, nuk kanë pasur detyrim për deklarimin e kursimeve cash të tyre. Në rast se në analizën financiare duhet të përfshihen dhe prindërit për shkak të jetesës faktike me ta, metodologjia e ndërtimit të analizës financiare duhet të jetë e ndryshme. Në përputhje me një metodologji të tillë, tepricat vjetore, të paktën deri në nivelin e të ardhurave të nënës, duhet të konsiderohen si mundësi kursimi<sup>60</sup>”*. Në përfundim, subjekti deklaroi se Komisioni duhet të zbatojë parimin e proporcionalitetit në rastin e konsiderimit si të saktë të balancës negative.

<sup>60</sup> Për sa kohë në fund të vitit 2010 balanca e fondeve rezulton në shumën 25.862 lekë, Komisioni duhet të përfshijë si të ardhur për vitin 2011 të ardhurat nga pensioni i nënës për vitin 2010, në shumën 25.862 lekë. Në fund të vitit 2011, balanca e fondeve është në shumën 15.881 lekë, shumë e cila do të shërbejë si e ardhur në vitin 2012. Në fund të vitit 2012, balanca e fondeve është në shumën 646.945, më e madhe sesa vlera e të ardhurave nga pensioni në vitin 2012, duke i shtuar dhe të ardhurat e periudhës së kaluar, në vlerën 15.881 lekë. Për këtë arsye, si të ardhura të periudhës së kaluar do të njihen të ardhurat në shumën 180.270 lekë (15.881 + 164.389). Në fund të vitit 2013, balanca pozitive është në shumën 622.384 lekë, por për vitin 2014 do të përfshihen të ardhura nga periudha e kaluar, shuma prej 350.017 lekësh (180.270 + 169.747). Në fund të vitit 2014, balanca pozitive rezulton të jetë në shumën 751.125 lekë, por si të ardhura për vitin 2015 do të njihet vetëm mundësia e prindërve në shumën 546.868 lekë (350.017 + 196.851). Në fund të vitit 2015, analiza financiare do të rezultojë me balancë pozitive në shumën 554.672 lekë, e cila do të shërbejë si e ardhur për vitin 2016.

## **Arsyetime ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**7.5** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**7.6** Sikundër u analizua më lart në vendim, për arsye se subjekti i rivlerësimit ka pasur jetesë të përbashkët faktike me prindërit, këta të fundit u përfshinë në analizën financiare. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe duke vënë në balancë vlerën e pamjaftueshmërisë në shumën 160.553 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e llogarive bankare gjatë vitit 2015, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij vlerësohet se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij.

### **Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kriterit të pasurisë**

**8.** Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

**9. Në përfundim,** trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Nertila Ndrejoni, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**1.** AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja (ish-DSIK) ka dërguar një raport me shënimin “Sekret”.

**2.** Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2024, kërkoi nga AKSIK-ja deklasifikimin e raportit mbi kontrollin e figurës të znj. Nertila Ndrejoni, si dhe përditësimin e raportit me informacionet shtesë.

**3.** AKSIK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., të vitit 2017, ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Nertila Ndrejoni, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë 16.4.2024, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas raportit, subjektin e rivlerësimit Nertila B. Ndrejoni, në datën 3.7.2017 asaj i është refuzuar viza amerikane. Kjo rrethanë nuk është pasqyruar në deklaratën për kontrollin e figurës, pasi subjekti i rivlerësimit e ka plotësuar atë në datën 16.1.2017 (6 muaj para refuzimit të vizës).

4. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Nertila Ndrejoni.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

5. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga AKSIK-ja, Komisioni kreu hetim administrativ pranë organeve verifikuese dhe kërkoi informacion të përditësuar për subjektin e rivlerësimit si pranë Prokurorisë së Përgjithshme<sup>61</sup>, edhe pranë Prokurorisë së Posaçme dhe Krimin të Organizuar<sup>62</sup>, nëse ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit.

6. Pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.11.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni vëren se nuk ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit të rivlerësimit.

7. Pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2021, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, nuk rezultoi që në emër të subjektit Nertila Ndrejoni të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

8. Sa rezulton, Komisioni vëren se: (i) nuk ka informacion apo indicie që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës; (ii) nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit; (iii) nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal për subjektin e rivlerësimit; (iv) nuk ka të regjistruar procedim penal, kallëzim penal apo të dhëna implikuese për lidhje me persona të përfshirë në veprimtari kriminale me subjektin e rivlerësimit, referuar të dhënave të administruara gjatë hetimit; (v) nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera, që të rezultojnë në kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016; si dhe; (vi) meqenëse refuzimi i vizës nuk lidhet me asnjë prej elementeve të hetuara nga Komisioni, nuk konstatohen problematika për sa i përket kriterit të vlerësimit të figurës së subjektit të rivlerësimit.

#### **Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kriterit të figurës**

9. Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Nertila Ndrejoni, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>61</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2021.

<sup>62</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2021.

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

1. Subjekti i rivlerësimit Nertila Ndrejoni në periudhën 2005 – 2010 ka ndjekur studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe nga muaji nëntor i vitit 2010 ka ushtruar funksionin e ndihmës ligjore në Gjykatën e Lartë.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit, në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Nertila Ndrejoni. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- d) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) rezultateve të testimit në Shkollën e Magjistraturës.

### **3. Aftësitë profesionale**

Nga analiza e të dhënave të rezultuara, konstatohet se subjekti Nertila Ndrejoni deri më sot nuk ka ushtruar asnjëherë funksionin e gjyqtarit pranë ndonjë gjykate të shkallës së parë apo të apelit. Rrjedhimisht, për këtë subjekt, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk disponon të dhëna për veprimtarinë e saj.

#### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit Nertila Ndrejoni ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën civile dhe administrative, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ajo ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit - ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë. Evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes, pretendimet e parashtruara para Gjykatës së Lartë, si dhe pretendimet e ngritura nga rekursuesi, bazuar në ligjin për Gjykatën e Lartë dhe praktikën e kësaj gjykate.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Subjekti ka pasqyruar në mënyrë të qartë dhe me strukturë të mirorganizuar mendimet ligjore. Nga 5 dosjet e shortuara, rezultoi se në 4 raste mendimi i ndihmësit ligjor përputhet me vendimmarrjen e gjykatës, ndërkohë që në 1 rast mendimi i ndihmësit ligjor nuk përputhet me vendimmarrjen e gjykatës.

### **4. Aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Lartë, rezulton se ndihmësja ligjore Nertila Ndregjoni ka hartuar relacione për 683 çështje me natyrë civile dhe administrative. Nga përmbajtja e dokumenteve të shqyrtuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka studiuar çështjet gjyqësore dhe ka relatuar për çdo shkallë të gjykimit, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, thelbin e analizës ligjore, si dhe shkaqet e rekursit. Këto veprime i ka materializuar në relacionin ligjor, ku ka plotësuar elementet procedurale të kërkuara, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 25 të rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. \*\*\*, datë 12.9.2014, të kryetarit të kësaj Gjykate.

## **5. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

### *a) Etika në punë*

Në burimet arkivore në Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk administrohen të dhëna mbi etikën e ndihmësës ligjore Nertila Ndregjoni. Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023, të Gjykatës së Lartë, për subjektin e rivlerësimit Nertila Ndregjoni përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është marrë asnjë masë disiplinore në ushtrimin e funksionit si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë.

### *b) Integriteti*

Konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e subjektit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

### *c) Paanësia*

Nga dokumentet e analizuara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, si dhe nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Nertila Ndregjoni të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave. Asnjëra prej çështjeve nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

## **6. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

### *a) Aftësitë e komunikimit dhe aftësia për të bashkëpunuar*

Në dokumentet ligjore të analizuara, nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore, e qartë, e plotë dhe e saktë.

## **Rezultatet e testimit në Shkollën e Magjistraturës**

7. Komisioni vëren se neni 179/b i Kushtetutës, ndërmjet të tjerave, në pikën 4 parashikon se procesit të rivlerësimit *ex officio* i nënshtrohen edhe këshilltarët ligjorë në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, si dhe ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme. Në vijim, neni 42 i ligjit nr. 84/2016,

në pikën 2 parashikon se subjektet e mësipërme vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; b) rezultatet e testimit në Shkollën e Magjistraturës.

**8.** Në zbatim të parashikimeve të mësipërme ligjore, Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2018, ka përcjellë pranë Komisionit rezultatet e dy fazave të testimit të subjekteve këshilltar ligjor në datat 7-8 maj të vitit 2018, ku konstatohet se totali i pikëve në fazën e parë është vendosur 100 pikë dhe në fazën e dytë 200 pikë. Rezulton se subjekti i rivlerësimit Nertila Ndrejoni në fazën e parë të testimit (njohuritë e përgjithshme) ka marrë 40 pikë, ndërsa në fazën e dytë të testimit (njohuritë profesionale) 17 pikë.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**9.** Nga informacioni i administruar nga zyra e denoncimeve pranë Komisionit, rezulton se nuk ka denoncime të depozituara për subjektin Nertila Ndrejoni. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjet e shortuara, nga ku Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me sa vijon:

**10. Çështja administrative nr. \*\*\* regj.,** që u përket palëve ndërgjyqëse - paditës P. Z., të paditura \*\*\* - me objekt “Anulimi pjesërisht i aktit administrativ, urdhri për sa i përket përcaktimit të gradës policore” etj.

**10.1** Nga faktet e analizuar, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka konstatuar faktin se e drejta e paditësit P. Z. për të paraqitur kërkesëpadi në gjykatë është e parashkruar (parashkrimi shues), për shkak se është bërë tej afateve të parashikuara në ligj; (ii) Opinioni ligjor i subjektit se “Gjykatat e faktit nuk kanë bërë një hetim të plotë e të gjithanshëm, nuk e kanë zgjidhur drejt mosmarrëveshjen objekt gjykimi dhe Gjykata e Apelit nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar këtyre pretendimeve të ankuesit” nuk është marrë në konsideratë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë; (iii) Arsyetimi i subjektit se “Gjykata e Apelit nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të ankuesit” është i paqartë, pasi në relacion nuk pasqyrohen pretendimet konkrete, të cilat nuk janë marrë në shqyrtim; (iv) Subjekti nuk ka identifikuar saktë objektin dhe shkaku e padisë, pasi nuk ka analizuar përmbajtjen e kërkesëpadisë sipas jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

**10.2** Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se sipas ligjit organik të kohës, mendimi i ndihmësit ligjor nuk është i detyrueshëm për Kolegjin përkatës të Gjykatës së Lartë dhe se dhënia e opinionit ligjor për zgjidhjen e çështjes është një veprimtari e pavarur, që mbështetet mbi bazën e bindjes së brendshme, të krijuar në varësi të studimit të dosjes, fakteve, provave dhe ligjit material e procedural. Parashkrimi i padisë shuan të drejtën e padisë në kuptimin material, por nuk shuan të drejtën e padisë në kuptimin procedural. Lënia jashtë trajtimit nga ana ime e kësaj çështjeje në relacionin përkatës lidhet pikërisht me faktin se paditësi gjatë ecurisë së gjykimit, në përputhje me të drejtën e disponimit të padisë së garantuar nga ligji procedural civil, i orientoi kërkimet drejt pavlefshmërisë absolute të akteve administrative. Në kushtet kur objekti dhe shkaku i padisë nuk mund të identifikoheshin qartësisht se ishin të lidhura vetëm me pavlefshmërinë absolute të akteve administrative apo dhe me atë relative, nuk mund të

evidentoja çështjen e parashkrimit të padisë, sidomos kur bëhej fjalë për një padi që në gjendjen e pranuar për shqyrtim nga gjykatat e faktit, pas ndryshimit të objektit të kërkimeve, nuk mund t'i nënshtrohej afatit të parashkrimit. Në rastin konkret, pala paditëse ka pretenduar pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, por pa specifikuar më tej. Nga ana tjetër, pavlefshmëria absolute mund të ngrihet dhe kryesisht nga ana e Gjykatës. Prandaj, për shkakun e të qenit të pretendimeve të përgjithshme dhe të pakonkretizuara, subjekti i rivlerësimit ka krijuar bindjen e mbështetur në akte, se duhet bërë një rihetim (prishje dhe rigjykim), në mënyrë që t'u jepej përgjigje të arsyetuar pretendimeve të ankuesit, por nisur nga numri i madh i çështjeve të ngjashme, problematika e hasur dhe rëndësia e orientimit të gjykatave të themelit dhe palëve, interesave publikë dhe atyre financiarë, subjekti i rivlerësimit ka propozuar vlerësimin për unifikim të rastit. Më tej, subjekti shpjegoi se në pjesën arsyetuese të vendimeve të gjykatave të faktit nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme se përse në rastin konkret kërkimet e paditësit lidhen me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ dhe jo me atë relative. Në këtë kuptim, nuk kishte një përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Apelit, se përse padia nuk duhet të konsiderohej e parashkruar sipas shkakut të ngritur në ankim nga pala e paditur. Për këto arsye komplekse, saktësimi i tyre nuk mund të bëhej në dhomën e këshillimit, pasi një pjesë e mirë e pretendimeve dhe e prapësimeve kishin ndodhur në themel dhe gjatë zhvillimit të procesit, ndërsa vlerësimi i rekursit në Gjykatë të Lartë bëhet për çështje ligji dhe jo fakti e provash.

**10.3 Vlerësimi ligjor i Komisionit –** Pasi analizoi pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në prapësime dhe në seancën dëgjimore, Komisioni vëren se në rastin konkret pretendimet e paditësit P. Z. kanë të bëjnë me pavlefshmërinë relative të akteve administrative, së cilës Kolegjet e Bashkuara nuk mund t'i hyjnë për shkak të parashkrimit të së drejtës së paditësit për të bërë padi në gjykatë, pasi ka kaluar afati 30-ditor i ankimit. Lidhur me identifikimin e objektit dhe shkakut të padisë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>63</sup> në jurisprudencën e tyre kanë arritur në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadi në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet dhe kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadi. Ndërsa lidhur me shkakun e padisë, kanë konkluduar se dispozita ligjore nuk është shkak i padisë, pasi ky i fundit identifikohet duke e parë të lidhur me faktet e pretenduara, që kanë cenuar të drejtën subjektive apo interesat e ligjshëm të paditësit. Në rastin konkret, paditësi ka pretenduar pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, ndërkohë që Kolegjet e Bashkuara kanë konstatuar se pretendimet e paditësit kanë të bëjnë me pavlefshmërinë relative të akteve administrative dhe, për këtë shkak, kanë vlerësuar se paditësi i është parashkruar e drejta e padisë për të paraqitur padi në gjykatë.

**10.4 Megjithatë,** Komisioni vëren se pikërisht pasja e një dyzimi nga ana e subjektit të rivlerësimit, mes cilësimit të shkaqeve të ngritura si raste të pavlefshmërisë absolute apo si raste të pavlefshmërisë relative dhe arsyetimi i munguar për to nga gjykatat, për shkak të të qenit të pretendimeve të përgjithshme dhe të pakonkretizuara, por pa i cenuar të drejtën palës për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të drejtës së gjykatës për të cilësuar kryesisht

---

<sup>63</sup> Vendimi nr. 3, datë 29.3.2012.



në seancë publike pas debatit, ka çuar në qëndrimin e subjektit për të propozuar shqyrtimin në seancë, me qëllim që të kuptohet natyra dhe qëllimi i shkakut dhe objektit të padisë e, rrjedhimisht, bazueshmërinë ose jo të shkaqeve të ngritura.

**10.5** Gjithashtu, Komisioni i gjen bindëse pretendimet e subjektit se mendimi i ndihmësit ligjor nuk është i detyrueshëm për Kolegjin përkatës në Gjykatën e Lartë dhe se dhënia e opinionit ligjor për zgjidhjen e çështjes është një veprimtari e pavarur, që mbështetet në bindjen e brendshme, të krijuar në varësi të studimit të dosjes, fakteve, provave dhe ligjit material e procedural.

**10.6 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

**11. Çështja civile nr. \*\*\* regj.**, që u përket palëve ndërgjyqëse - paditës L. S., e paditur \*\*\*-ja - me objekt “Detyrimi për pagimin e 13 pagave dhe shpërblimin për vjetërsi në punë”.

**11.1** Nga faktet e analizuara, Komisioni kërkoi shpjegime për konstatimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë mendim lidhur me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural nga gjykatat e faktit, sikurse parashikohet në nenin 21 të ligjit nr. 8588/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**11.2** Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar:

*Së pari*, në lidhje me hedhjen në sistem të çështjes dhe njoftimit të datës së kalimit në gjykim, mendimi i ndihmësit hidhej në sistem në mënyrë formale. Vetëm më pas vijoje me plotësimin e shkaqeve edhe në këtë rubrikë, duke i plotësuar me shkrim, qoftë para fazës së relativitetit verbal apo me gojë, gjatë fazës së relativitetit të çështjes para Kolegjit përkatës, në varësi të natyrës së çështjes, problematikës dhe kompleksitetit të çështjes e volumit të shkaqeve.

*Së dyti*, subjekti parashitri se mendimi i saj është në përputhje me sa ka vendosur Kolegji, duke mbajtur në konsideratë shkaqet e referuara në pjesën e rekursit.

*Së treti*, subjekti parashitri se qëllimi i hedhjes së relacionit në sistem ishte procedimi i shpejtë i çështjeve dhe në bazë të parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm për përgatitjen e çështjes për relativitet para Kolegjit përkatës. Nisur nga dinamika e punës, shpejtësia dhe mundësia e plotësimit dhe përtëritjes së relacionit në çdo kohë, deri në çastin e relativitetit verbal, relacioni deri në datën e relativitetit mund të plotësohej e përtërihej. Madje, edhe pyetjet e anëtarëve të Kolegjit të Gjykatës së Lartë ishin të dobishme në fokusimin e shkaqeve dhe debatimin e tyre.

*Së katërti*, në relacionin e çështjes së mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë opinion më të gjatë sesa relacioni i përkohshëm, që rezulton i hedhur në sistem. Kjo për faktin se relacioni është plotësuar pas relativitetit verbal nga subjekti dhe nga pyetjet e bëra nga anëtarët e Kolegjit përkatës. Në përfundim, subjekti deklaroi se është një praktikë pune e konsoliduar në Gjykatën e Lartë, që në relacion shënohet përmbledhja e fakteve e procedurave dhe

fiksimi vetëm i një mendimi konciz, si një praktikë e kufizuar vetëm për çështjet që kalonin për shqyrtim në seancë gjyqësore.

**11.3 Vlerësimi ligjor i Komisionit** – Pasi analizoi pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në prapësime dhe në seancën dëgjimore, Komisioni vëren se praktika e Gjykatës së Lartë parashikon edhe relatimin verbal para trupit gjykues, në funksion të dhënies së përgjigjeve për pyetjet e parashtruara prej tyre. Sa rezulton, gjenden bindëse shpjegimet e subjektit për sa kohë Kolegji nuk ka vendosur kthimin e çështjes për plotësim hetimi dhe dhënien e një mendimi më të detajuar, çka konfirmon faktin se relatimi dhe relacioni i rastit ka qenë i mjaftueshëm lidhur me mundësinë e vendimmarrjes mbi rastin.

**11.4 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

**12. Çështja civile nr. \*\*\* regj.**, që u përket palëve ndërgjyqëse - paditës D. L., të paditura Drejtoria e Policisë së Qarkut \*\*\*, Drejtoria e \*\*\* së Shtetit - me objekt “Detyrimi i palës së paditur të kryejë ekuivalentimin e gradës, duke i dhënë paditësit gradën ‘Nënkomisar’”.

**12.1** Nga faktet e analizuar, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimet se: (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka identifikuar objektin dhe shkakun ligjor të padisë sipas orientimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar pretendimet e palës së paditur të ngritura në të dyja shkallët e gjykimit lidhur me parashkrimin e padisë së palës paditëse.

**12.2** Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se sipas ligjit organik të kohës mendimi i ndihmësit ligjor nuk është i detyrueshëm për Kolegjin përkatës së Gjykatës së Lartë, dhe se dhënia e opinionit ligjor për zgjidhjen e çështjes është një veprimtari e pavarur, që mbështetet në bindjen e brendshme, të krijuar në varësi të studimit të dosjes, fakteve, provave dhe ligjit material e procedural. Shkaku i padisë dhe cilësimi i drejtë ligjor i saj përcaktohet vetëm pas zhvillimit të një debati, dhe shumë shkaqe pavlefshmërie të pretenduara si relative gjykata mund t’i cilësonte kryesisht sipas parimit *iura novit curia*, pra gjykata e njeh më mirë ligjin që duhet të zbatohet. Mund të ndodhte që shkaku i padisë të cilësohej si shkak pavlefshmërie absolute, por që më parë u duhet bërë me dije palëve ndërgjyqëse, fakt ky që nuk mund të bëhet në dhomë këshillimi, mbështetur në nenin 9 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit “gjykata fton palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes”. Fakti që ka propozuar mospranimin e rekursit, vërteton se identifikimi i shkakut dhe objektit sipas përcaktimeve që lidhen me padinë për pavlefshmërinë relative të aktit administrativ, ka qenë i saktë nga gjykatat e faktit dhe, si i tillë, duhet konsideruar se është i mjaftueshëm për arritjen e përfundimit. I vetmi ndryshim në raport me vendimmarrjen e Kolegjit është që në këtë vendim është arsyetuar për parashkrimin e padisë në kushtet e dijenisë së prezumuar të paditësit që nga momenti i dhënies së gradës, ndërkohë që subjekti në relacionin e bërë nuk e ka ngritur çështjen e parashkrimit, pasi nuk vërtetohej

dijenja e paditësit për fillimin e afatit të parashkrimit nëpërmjet një akti formal njoftimi të aktit përkatës administrativ, në respektim rigoroz të parashikimeve të ligjit specifik<sup>64</sup>.

**12.3** Vlerësimi ligjor i Komisionit – Komisioni, pasi analizoi pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në prapësime dhe në seancën dëgjimore, vëren se referuar përmbajtjes së relacionit subjekti nuk ka analizuar kërkimet e paditësit në padi lidhur me kundërshtimin e urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, nëse këto kërkime kanë lidhje me pavlefshmërinë relative të aktit administrativ apo me pavlefshmërinë absolute, rrethanë kjo mjaft e rëndësishme në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative për sa i përket vlerësimit nëse paditësi e ka paraqitur padinë brenda afatit ligjor, sipas parashikimeve të nenit 328<sup>65</sup> të Kodit të Procedurës Civile të kohës, kur kërkimet kanë lidhje me pavlefshmërisë relative apo nëse paraqitja e padisë nuk është e lidhur me ndonjë afat ligjor, për shkak se kërkimet i referohen pavlefshmërisë absolute<sup>66</sup>. Për më tepër që pala e paditur në të dyja shkallët e gjykimit ka pretenduar se padia e palës paditëse është e parashkruar, pra këto pretendime janë ngritur si shkaqe ankimi në të dyja shkallët e gjykimit.

**12.4** Sa rezulton, relacioni dhe mendimi ligjor i përpiluar nga subjekti nuk është i njëjtë me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për sa i përket kalimit të çështjes në seancë gjyqësore dhe për sa i përket zgjidhjes përfundimtare të tij, por megjithatë Komisioni mban në konsideratë faktin se mendimi i ndihmësit ligjor nuk është i detyrueshëm për Kolegjin përkatës në Gjykatën e Lartë dhe se dhënia e opinionit ligjor për zgjidhjen e çështjes është një veprimtari e pavarur, që mbështetet në bindjen e brendshme.

**12.5 Në përfundim**, gjetjet e Komisionit lidhur me këtë çështje nuk kualifikohen në fakte apo rrethana relevante, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

**13. Çështja civile që u përket palëve ndërgjyqëse** - paditës Gj. Z., i paditur \*\*\*- me objekt “Shpërblimi me pagë për zgjidhje të kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara”.

**13.1** Nga faktet e analizuara, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se subjekti në mendimin e saj ligjor nuk i referohet nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohen rastet se kur mund të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë, si dhe nuk ka arsyetuar se përse pretendimet e palës së paditur nuk bazohen në parashikimet e kësaj dispozite ligjore.

**13.2** Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se: *“Në mënyrë koncize kam konkluduar se vendimi i Gjykatës së Apelit, objekt rekursi, nuk ka vend të cenohet, çka referon dhe evokon në mënyrë të padyshimtë zbatimin e nenit 472*

<sup>64</sup> Mendimi i subjektit bazohej në bindjen e krijuar nga arsyetimi i gjykatave, se nuk provohej njoftimi formal i urdhrave, dhe për sa kohë nuk provohej ky fakt, nuk provohej as ecja e afatit dhe kalimi i tij. Duke qenë këto çështje fakti, subjekti nuk i ka çmuar t'i përmendë në opinionin e saj ligjor, që ishte fokusuar në zbatimin ose jo të ligjit.

<sup>65</sup> Kodi i Procedurës Civile, neni 328: *“Afati për paraqitjen e padisë ndaj një akti administrativ është tridhjetë ditë nga dita e shpalljes ose e njoftimit të vendimit të organit më të lartë administrativ, që ka shqyrtuar ankesën në rrugë administrative, përveç kur ligji parashikon ankimin e drejtpërdrejtë në gjykatë”.*

<sup>66</sup> Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues me nr. 3/2008, kanë arsyetuar se: *“...nëse pretendohet pavlefshmëria absolute e akteve, kërkim që nuk është i ndërvarur nga ndonjë afat parashkrimi, gjykata nuk mund të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, por në zbatim të nenit 121 të Kodit të Procedurave Administrative dhe 331 të Kodit të Procedurës Civile konstaton pavlefshmërinë për efekt të zgjidhjes së pasojave juridike që janë krijuar nga akti...”.*

*të Kodit të Procedurës Civile, pasi Gjykata e Apelit ka bërë një hetim të plotë e të gjithanshëm të konfliktit, duke e zgjidhur çështjen në mënyrë të drejtë, në pajtim me ligjin. Shkaqet e pretenduara ish-in aq haptazi të pambështetura, saqë vetë referenca dhe leximi i tyre ishte arsye evidente dhe më se e mjaftueshme për arsyetimin e tyre, si pretendime haptazi që nuk bazohen në parashikimet e ligjit procedural”.*

**13.3** Vlerësimi ligjor i Komisionit – Komisioni, pasi analizoi pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në prapësime dhe në seancën dëgjimore, vëren se subjekti në cilësinë e ndihmësit ligjor ka përgatitur relacionin për çështjen konkrete të strukturuar në tri pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen mosmarrëveshja objekt gjykimi, dispozitivi i vendimit të gjykatës së rrethit, më pas pasqyrohet dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit, që ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit dhe arsyetimi i saj; (ii) shkaqet e rekursit; (iii) mendimi i ndihmësit ligjor. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban asnjërin prej rasteve të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, çka përputhet me mendimin e ndihmësit ligjor, edhe pse subjekti nuk bën referencë në dispozitën ligjore, ku parashikohen rastet se kur mund të ushtrohet rekurs.

**13.4 Në përfundim**, Komisioni i gjen bindëse shpjegimet e subjektit dhe vlerëson se kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

#### **Konkluzion i Komisionit për rivlerësimin e aftësive profesionale**

**14.** Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se veprimtaria që ushtron këshilltari ligjor i Gjykatës së Lartë, ka karakter këshillues dhe ndihmës, në ndryshim nga ajo e gjyqtarit, e cila ka karakter vendimmarrës (vendimi nr. \*\*\*, datë 31.1.2024). Rregullat procedurale që normojnë veprimtarinë e Gjykatës së Lartë, kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rolin dhe pozicionin, si dhe kompetencat e këshilltarit ligjor gjatë procesit të vendimmarrjes (shihni vendimet nr. 49, datë 5.10.2023 dhe nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese).

**15.** Sa rezulton, veprimtaria e ndihmësit/këshilltarit ligjor ka natyrë këshilluese dhe ndihmëse dhe nuk mund të konsiderohet si pjesë e procesit vendimmarrës. Në këtë kuptim, performanca apo vlerësimi profesional i këshilltarit ligjor jo domosdoshmërisht duhet të konsistojë në përputhshmërinë e mënyrës së propozuar prej tij për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me atë të disponuar nga trupi gjykues me vendim gjyqësor. Rëndësi për përcaktimin e nivelit të aftësisë profesionale është paraqitja e fakteve dhe e rrethanave procedurale, në mënyrë të detajuar, paraqitja e analizës së fakteve dhe arsyetimit nga gjykatat e themelit, si dhe paraqitja e shkaqeve të rekursit. Vlerësimi i nivelit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit duhet bërë në tërësi dhe në mënyrë proporcionale, duke mbajtur parasysh numrin e çështjeve, natyrën dhe kompleksitetin e tyre, praktikën administrative të krijuar në Kolegj (mundësinë e relatimit me gojë, plotësimin, pyetjeve dhe rielatimit, kur ishte e nevojshme nga ana e Kolegjit përkatës të Gjykatës së Lartë).

**16.** Referuar parashikimeve të nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni do të vlerësojë subjektin Nertila Ndrejoni bazuar në: (i) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura;

(ii) rezultatet e testimit në Shkollën e Magjistraturës. Sipas parashikimeve në nenin 165/4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit nuk bën pjesë te subjektet që kanë fituar të paktën 60% të pikëve të testimit të aftësive profesionale e, për pasojë, nuk është kualifikuar për të ndjekur formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Meqenëse testimi pranë Shkollës së Magjistraturës është në vetvete një nga kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues vëren se subjekti Nertila Ndrejoni është vlerësuar në këtë testim me një rezultat nën pragun prej 60% të pikëve, rezultat i cili nuk e ka penguar subjektin e rivlerësimit për vijimin e ushtrimit të detyrës. Për pasojë, kjo nuk përbën një shkak relevant për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit me mangësi në aspektin e kriterit të vlerësimit të njohurive profesionale.

**17. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk u provuan indicie apo elemente që cenojnë kriterin profesional të subjektit të rivlerësimit Nertila Ndrejoni dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektive dhe efiçente në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua e aftë për kriterin profesional.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Nertila Ndrejoni, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a.** Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- b.** Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c.** Lidhur me kriterin e vlerësimit profesional, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a dhe shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, dhe referuar shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, pikës 1 të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Nertila Ndrejoni, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë.
  2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.9.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Relatore**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*